



Komuna e Klinës

Zyra e Kryetarit

01Nr. 112-9087/26

Klinë, më 31.03.2026

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040, nenin 69 dhe 71 të Ligjit për Zyrtares Publik, nr.08/L-197, dispozitat e nenit 13 paragrafi 3 të Ligjit, Nr.08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit, Nr.08/L-197 për Zyrtares Publik, dispozitat e nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores së QRK-së, nr.28/2024 për Pezullim nga Marrëdhënia e Punës, sipas detyrës zyrtare, kryetari i komunës, nxjerr **ketë**:

## VE N D I M

1. I punësuar, z. **Lorenc Marku** nga fshati Videjë Komuna Klinë, i lindur më [redacted] me numër personal të DI-[redacted] i sistemuar në vendin e punës Laborant në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, i pezullohet sipas detyrës zyrtare marrëdhënia e punës në shëndetësi pa kompensim të pagës më rastin e plotfuqishmërisë së këtij vendimi e deri në përfundim apo ndërprerje të mandatit të Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
2. Pas përfundimit apo ndërprerjes së mandatit të Drejtorit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përveç se kur vendoset ndryshe nëpunësi i lartpërmendur rikthehet në pozitën e mëparshme të vendit të punës, në pozitën Laborant në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
3. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

## A r s y e t i m

Kryetari i komunës së Klinës duke u bazuar në dispozitat e nenit 69 dhe 71 të Ligjit për Zyrtares Publik nr.08/L-197, si dhe plotësim ndryshimet e tij më Ligjin nr.08/L-294, Dispozitat e Rregullores nr.28/2024 për Pezullim nga Marrëdhënia e Punës, sipas detyrës zyrtare pas njoftimit të nëpunësit bën pezullimin e marrëdhënies së punës për nëpunësin Lorenc Marku, i sistemuar në pozitën e Laborant në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Klinë. I përmenduri me dt.24.03.2026 nga ana e Kryetarit të Komunës së Klinës është emëruar Drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, prandaj i njëjti sipas legjislacionit në fuqi nuk mund të ushtroj te dy funksionet njëkohësisht.

Andaj, me qëllim të zbatimit të dispozitave ligjore, kryetari i komunës vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Te njoftohën:

- I përmenduri;
- Drejtoria e Financave;
- NJMBNJ, si dhe;
- Arkivit.

Kryetari  
Zenun Elezaj

